



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit**  
**Telecommunications Regulatory Authority**  
**Regulativni Autoritet Telekomunikacije**



DEPARTAMENTI I TELEKOMUNIKACIONIT

# PASQYRË E TREGUT TË TELEKOMUNIKACIONIT

Bazuar në informatat e pranuar nga Operatorët dhe Ofruesit e shërbimeve  
telekomunikuese

K3-2010

Prishtinë  
Dhjetor, 2010

## Përmbajtja

1. Hyrje .....	3
2 Pasqyre e përgjithshme .....	4
2.1 Pasqyra e te ardhurave nga shërbimet telekomunikuese .....	6
3 TELEFONIA FIKSE.....	7
3.1 Numri përdoruesve të telefonisë fikse .....	7
3.2 Trafiku telefonisë fikse .....	9
3.3 Struktura e thirrjeve ne telefoninë fikse.....	10
3.4 Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve të telefonisë fikse.....	12
4. TELEFONIA Mobile .....	13
4.1 Përdoruesit e telefonisë mobile.....	13
4.2 Ndarja e tregut sipas parapaguesve.....	14
4.3 Te ardhurat e telefonisë mobile.....	15
4.4 Struktura e përdoruesve te telefonisë mobile .....	16
4.5 Trafiku telefonik.....	16
5 INTERNETI.....	18
5.1 Numri i përdoruesve me akses broadband në Internet dhe struktura e tyre.....	18

## 1. Hyrje

Rëndësia e sektorit të telekomunikacionit është e njohur jo vetëm për shkak të zhvillimit të tij të shpejtë, por edhe si një shtytje e pakontestueshme në zhvillimin e ekonomive tjera, e në veçanti të shoqërisë së informacionit.

Në sferën ekonomike, shumëllojshmëria e shërbimeve telekomunikuese moderne, i ndihmon bizneset në rritjen e prodhimitarisë përmes krijimit të teknikave prodhuese më efikase dhe mundësisë së koordinimit të aktiviteteve brenda dhe në mes bizneseve, duke ndikuar kështu në ulje të kostos. Për më tepër, industria e telekomunikacionit siguron një burim kryesor të punësimit, dhe kontribuon me një pjesë të rëndësishme të Bruto Prodhimit Kombëtar (ang. GDP).

Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit (ART), me qëllim të informimit të ofruesve të licencuar dhe atyre potencial të shërbimeve të telekomunikacionit, palëve të interesuara dhe opinionit të gjerë, ka hartuar këtë Raport për gjendjen në tregun e telekomunikacionit, i cili përmban treguesit kryesor të Tregut të Telekomunikimeve.

Dokumenti në fjalë është përgatitur në bazë të të dhënave të dorëzuara nga operatorët e licencuar nga ART për ofrimin e shërbimeve mobile, fikse dhe atyre të internetit.

Duke pas në konsideratë ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave, jo të gjithë treguesit e raportuar nga operatorët publikohen në këtë raport .

Dokumenti ka natyrë periodike, përkatësisht çdo tre muaj operatorët e licencuar janë të obliguar t'i dorëzojnë ART –së pyetësorët e plotësuar me të dhënat që do të paraqiten në vazhdimin e këtij dokumenti. Kështu që raporti do të mund të pasurohet edhe me tregues të tjerë apo informacione statistikore më të plota për operatorët alternative dhe tregun në tërësi.

## 2. Pasqyrë e përgjithshme

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit mbi Telekomunikacionit janë krijuar kushtet për liberalizimin e tregut në vend. Deri më tani janë liberalizuar të gjitha shërbimet telekomunikuese, duke përfshirë shërbimet e telefonisë fikse, mobile, internetit, shërbimeve me vlerë të shtuar, etj.

Autorizimet e para për shërbimet e internetit janë lëshuar në maj të vitit 2005 (operatorët e licensuar: PTK, IPKO, dhe KUJTESAnet).

Në shtator të vitit 2006 është lëshuar licenca e dytë (konzorciumi IPKO/Telekom Sllovenije) për ofrimin e shërbimeve të telefonisë fikse në nivel nacional.

Sa i përket tregut të telefonisë mobile, deri më tani janë licensuar dy operator (2G) nga ART-ja: PTK-Vala në brezin 900MHz, në vitin 2004, si dhe konzorciumi IPKO/Telekom Sllovenije/Mobitel (brezi 900/1800MHz) në vitin 2007.

Pas aprovimit të Kornizës për MVNO nga ART në maj të vitit 2008, janë licensuar edhe dy operatorë: Dukagjini Telecommunications (D3mobile) operon bazuar në marrëveshjen komerciale me IPKOnet, ndërsa Dardafon.net (Zmobile) ka arritur marrëveshje me operatorin publik PTK/VALA.

Edhe pse të gjitha shërbimet telekomunikuese janë të liberalizuar deri më tani, megjithatë konkurrencë të plotë tani për tani kemi në sektorin e shërbimeve të internetit dhe telefonisë mobile, ndërsa për shërbimet e telefonisë fikse mund të themi se janë pjesërisht konkurruese.

Gjatë vitin 2010 janë licensuar nga ART katër (4) ndërmarrje për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve telekomunikuese, krahasuar me numrin e licencave të lëshuara nga ART gjatë tërë vitit 2009 është i njëjtë, përkatësisht gjatë vitit 2009 janë licensuar katër (4) ndërmarrje.

Deri me tani ART-ja ka lëshuar gjithsej 47 licenca të shërbimeve telekomunikuese, të cilat janë paraqitur në tabelën në vijim (tabela 1).

Ndërsa shërbimet, të cilat ofrohen janë si në vijim:

- Shërbimet e telefonisë fikse
- Shërbimet e telefonisë mobile
- Shërbimet brezgjera (ang. Broadband)
- Shërbimet e linjave me qira
- Shërbimet me vlerë të shtuar

**Tabela 1:** Numri i autorizimeve/licencave të lëshuara nga ART-ja

Lloji i licensës	Numri i operatorëve të licensuar
Licenca për telekomunikime mobile (MNO)	2
Licenca e shërbimeve fikse kombëtare	3
Licenca e shërbimeve te internetit	13
Licenca e shërbimeve telekomunikuese ndërkombëtare	5
Licenca për nyje dhe pajisje telekomunikuese ndërkombëtare	5
Licenca e shërbimeve me vlerë të shtuar	17
Licenca për shërbime mobile virtuale (MVNO)	2

Në tabelën në vijim janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur disa nga indikatorët kryesor të shërbimeve telekomunikuese.

**Tabela 2:** Indikatorët Kryesor të Tregut të Shërbimeve Telekomunikuese

Përshkrimi	K3 2010	K2 2010	Ndryshimi ne krahasim me K2 2010 %	K3 2009	Ndryshimi ne krahasim me K3 2009 %
1. Numri i linjave te telefonisë fikse	289154	289154	-	-	-
2. Numri i parapaguesve te telefonisë fikse	88716	92801	-4.4	84114	5.29
3. Penetrimi i telefonisë fikse	4.48%	4.4	0.08	4.46	0.02
4. Numri i parapaguesve të telefonisë mobile	1537164	1468002	4.71	1,297407	18
5. Penetrimi i telefonisë mobile %	74	71	3.41	63	18
6. Numri i parapaguesve te internetit	105061	104,364	0.7	136,711	-23
7. Numri i parapaguesve te internet-it ( %)	5.08	5.04	0.04	6	-1.52
8. Te hyrat (ne mije €)					
<i>Nga: Telefonia fikse</i>	4,843,063	4,759,074	1.76	4,870,769	-0.56
<i>Telefonia mobile</i>	49,543,592	41,131,707	20	48,000,572	0.39
<i>Linjat me qira</i>	447069.13	395192.94	13.12	N/a	N/a
<i>Akcesi ne internet</i>	4169636.41	3682275.72	13.23	N/a	N/a

Gjatë tremujorit të III-të të vitit 2010 numri i përdoruesve të telefonisë fikse ka shënuar rënie, si rezultat i zvogëlimit të 5 000 përdoruesve të TK. Numri i përdoruesve të telefonisë fikse vlerësohet të jetë 88 000, prej të cilëve 8 000 për operatorin alternativë IPKO.

Gjersa telefonia fikse ka shënuar rënie të lehtë, telefonia mobile dhe qasje brezgjër (ang. Broadband) në Internet kanë shënuar rritje të numrit të përdoruesve.

Ne fund të tremujorit të III-të 2010, numri i përdoruesve të telefonisë mobile ka arritur shifrën prej **1,518,059** përdorues, që paraqet një rritje të ndjeshme prej **3.41 %** në krahasim me tremujorin paraprak të këtij viti, përkatësisht **18%** në krahasim me tremujorin e III-të të vitin 2009.


Numri i përdoruesve me qasje broadband në Internet ka shënuar rritje, duke arritur në 110 mijë, e cila paraqet një rritje simbolike prej 0.04%.

## **2.1. Pasqyra e të ardhurave nga shërbimet telekomunikuese**

Të hyrat nga shërbimet telekomunikuese për tremujorin e tretë të vitit 2010 janë 39,325,000.00€ .

Operatorët e telefonisë mobile dhe fikse, vazhdojnë të zotërojnë pjesën më të madhe të tregut me 90% të të ardhurave të gjithë sektorit. Të ardhurat e operatorëve mobil përbëjnë 82.37% të të ardhurave të gjithë tregut, ndërsa operatorët fiks zotërojnë 7.7%. Pjesën tjetër prej 9.18% e përbëjnë të hyrat nga shërbimet e internetit, si dhe pjesën prej 0.74 e përbëjnë të ardhurat nga linjat me qira.

Në figurën 1 është paraqitur ndarja e të hyrave sipas veprimtarisë



*Figura 1: Ndarja e të hyrave sipas veprimtarisë*

### 3. Telefonia fikse

#### 3.1. Numri përdoruesve të telefonisë fikse

Bazuar në të dhënat e operatoreve për tremujorin e tretë 2010, rezulton se janë rreth 88.7 mijë përdorues të telefonisë fikse, e cila ka një rënie në numrin e përdoruesve me afërsisht 4 mijë përdorues ose rreth 1.9 % krahasuar me tremujorin e II-të të vitit 2010.


Nëse krahasojmë ecurinë e zhvillimit të këtij tregu gjatë periudhës K IV 2007 e deri më K III 2010, rezulton që telefonia fikse nuk ka një zhvillim të qëndrueshëm, gjë e cila vërehet me lëvizjen e numrit të përdoruesve.

Në tabelën 3 është paraqitur ecuria e numrit të përdoruesve të telefonisë fikse:

*Tabela 3: Numri e përdoruesve të telefonisë fikse (2007-2010/III)*

	2007		2008		2009				2010				
	K1	K2	K1	K2	K3	K4	K1	K2	K3	K4	K1	K2	K3
<b>Përdoruesit e telefonisë fikse</b>													
<b>Individual</b>	75389	81500	74938	74990	76018	76870	77490	77608	75393	76766	75557	74628	
<b>Bizneset</b>	6960	6995	6669	6797	6833	6679	6624	6644	6691	6855	17244	14088	
<b>Totali I përdoruesve të telefonisë fikse</b>	82349	88495	81607	81787	82851	83549	84114	84252	82084	83621	92801	88716	

Norma e penetrimit të telefonisë fikse gjatë këtij tremujori të vitit 2010 ishte 4.29%, nivel ky që vazhdon të jetë shumë i ulët krahasuar me 45% në vendet e BE dhe të rajonit (figura 2).




*Figura 2: Penetrimi i telefonisë fikse 2007 - 2010*

Në tabelën 4 janë dhënë përqindjet e shfrytëzuesve të telefonisë fikse sipas llojit të përdoruesve. Bazuar në të dhënat e paraqitura vërehet se përqindja e përdoruesve individual është më e lartë në krahasim me përqindjen e bizneseve. Kurse në tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit 2010 vërehet një rritje e ndjeshme e përdoruesve të bizneseve.

*Tabela 4: Përdoruesit e telefonisë fikse sipas kategorisë*

	2007	2008				2009				2010		
	K1	K1	K2	K3	K4	K1	K2	K3	K4	K1	K2	K3
Individual %	91.55%	92.10%	91.83%	91.49%	91.41%	91.46%	91.58%	91.54%	91.46%	91.53%	80.56%	83.52%
Bizneset %	8.45%	7.90%	8.17%	8.51%	8.59%	8.54%	8.42%	8.46%	8.54%	8.47%	19.44%	16.48%





*Figura 3: Ndarja e tregut e operatorëve fiks sipas përdoruesve dhe te hyrave*


Në figurën 3 është paraqitur ndarja e tregut sipas përdoruesve dhe të hyrave ndërmjet operatorëve TK dhe IPKO.

### 3.2. Trafiku telefonisë fikse

Në figurën 4 është paraqitur ecuria e trafikut të telefonisë fikse nga të dy operatorët aktiv në treg.

Nga të dhënat e paraqitura mund të vërehet se trafiku i telefonisë fikse nga K4 2007 deri me K4 2009 karakterizohet me një rënie të vazhdueshme të lehtë. Kjo dukuri mund të jetë rezultat i zëvendësimit dhe trendit gjithnjë në rritje të përdorimit të telefonisë mobile në raport me telefonin fikse.

Nëse krahasohen të dhënat e trafikut në K3 2009 në raport me K3 2010 mund të vërehet se trafiku i telefonisë fikse ka shënuar rritje për 25%, ndërsa nëse i krahasojmë të dhënat e trafikut të K3 në raport me K2 2010 ka një rënie prej 5% (figura 4).



*Figura 4. Totali Trafiku i origjinar dhe terminuar i telefonisë fikse*

### 3.3. Struktura e thirrjeve në telefonin fikse


Në Figurë 5 është pasqyruar trafiku i detajuar telefonik sipas destinacionit të thirrjeve, i gjeneruar nga dy operatorët e rrjeteve dhe shërbimeve fikse:

- ✓ trafiku brenda rrjetit;
- ✓ trafiku drejt rrjeteve të tjerë fikse;
- ✓ trafiku drejtë rrjeteve mobile dhe
- ✓ trafiku ndërkombëtarë.

Në tremujorin e III-të të vitit 2010 nga rrjetet fikse janë origjinar 44.8 milion minuta, e cila përbën një rënie prej 4% në krahasim me tremujorin e II-të të vitit 2010, respektivisht është rritur për 25% në krahasim me tremujorin e III-të të vitit 2009.

Pjesën më të madhe të trafikut të përgjithshëm në rrjetin e telefonisë fikse e përbën trafiku i origjinar dhe terminuar brenda rrjetit me rreth 69% e trafikut, kurse pjesën tjetër të trafikut e përbejnë trafiku drejt rrjetit mobil me rreth 21% si dhe pjesën e mbetur ai ndërkombëtar me rreth 10%.

Nëse krahasojmë trafikun e origjinuar gjatë periudhës K1- K3 2010, vërejmë një rënie të vogël prej 2% në trafikun brenda rrjetit dhe drejtë rrjeteve mobile, ndërsa trafiku në rrjetin ndërkombëtar ka shënuar një rritje prej 3.32%.



*Figura 5: Trafiku i origjinuar fiks sipas desitacioneve*

Në Figurën 6 është pasqyruar trafiku i detajuar telefonik hyrës në rrjetet e dy operatorëve fiks sipas origjinës së thirrjeve:

- ✓ nga rrjete të tjera fikse,
- ✓ rrjetet mobile dhe
- ✓ trafiku hyrës ndërkombëtar.

Në këto të dhëna nuk janë përfshirë thirrjet brenda rrjetit.

Në tremujorin e tretë 2010 në rrjetet fiks janë terminuar 23.2 milion minuta, e cila përbën një rënie për 9.14% në krahasim me tremujorin paraprak të vitit 2010.

Nga të dhënat e paraqitura në grafik vërehet se trafiku hyrës ndërkombëtar zotëron pjesën më të madhe të thirrjeve të terminuara me mbi 85%, mirëpo, nga fundi i tremujorit të dytë vërehet një tendencë në rënien e këtyre thirrjeve. Ndërsa në thirrjet e rrjeteve mobile vërehet një rritje prej 63% në krahasim me tremujorin e dytë të vitit 2010.




Figura 6: Trafiku i hyrës i telefonisë fikse

### 3.4. Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve të telefonisë fikse

Në tabelën 6 janë paraqitur disa tregues të konsumit mujor të thirrjeve në minuta të përdoruesve të telefonisë fikse. Përdorimi është matur sipas trafikut total dalës dhe hyrës (thirrjet brenda rrjetit; thirrjet drejt rrjetit fiks dhe rrjetit mobil; thirrjet ndërkombëtare), pjesëtuar me numrin mesatar vjetor të përdoruesve të tel. fikse.


Tabela 6: Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve të telefonisë fikse 2010/III

	K1 2010	K2 2010	K3 2010
Origjinimi dhe terminimi i thirrjeve në rrjetin e vet (On net Calls)	115	115	117
Origjinimi i thirrjeve drejt rrjetëve të tjera të fikse (outgoing calls)	2	2	2
Origjinimi i thirrjeve drejt rrjetëve celulare (Fixed to Mobile outgoing calls)	34	38	37
Orgjonimi i thirrjeve drejt rrjetit ndërkombëtare (International outgoing calls)	12	11	18
Treminimi i thirrjeve nga rrjetet tjera fikse (incoming off net calls)	1	2	1
Terminimi i thirrjeve nga rrjetet celulare (Mobile to Fixed incoming)	7	8	12
Terminimi i thirrjeve nga rrjeti ndërkombëtare (International incoming calls)	85	87	74
<b>Totali i minutave per nje perdorues</b>	<b>370</b>	<b>379</b>	<b>377</b>

## 4. Telefonia mobile

### 4.1. Përdoruesit e telefonisë mobile

Telefonia mobile ka treguar rritje të vazhdueshme në tremujorin e III- të këtij viti. Numri i përdoruesve të telefonisë mobile shënoi rritje prej 3.41% duke ngritur numrin e përgjithshëm në 1.5 milion përdorues. Operatorët Mobil kanë raportuar se në tremujorin e tretë (K3/2010) rreth 7,000 përdorues të rinjë janë shtuar në rrjetin e tyre. Në figurën 7 është paraqitur shkalla e rritjes së përdoruesve nga vitet 2007 deri K3-2010.



*Figura 7: Numri përdoruesve mobil 2007-2010/III*

Shkalla e penetrimit të përdorimit të telefonisë mobile deri në fund të muajit shtator të vitit 2010 arriti në 74.26%, e cila në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2009 ka shënuar rritje 11.26% (figura 8).

Edhe përkundër rritjes së numrit të vazhdueshëm të përdoruesve të telefonisë mobile, penetrimi i këtij shërbimi është më i ultë në krahasim me vendet e rajonit dhe vendet e BE.




Figura 8: Penetrimi i telefonisë mobile

#### 4.2. Ndarja e tregut sipas përdoruesve

Në figurat e paraqitura më poshtë janë dhënë detalet e ndarjes së tregut të katër operatorëve mobil për tremujorin e III te vitit 2009 si dhe detalet për tremujorët I, II, dhe III të vitit 2010.




Figura 9: Ndarja e tregut K3 2009




Figura 10: Ndarja e tregut K1 2010




Figura 11: Ndarja e tregut K2 2010




Figura 12: Ndarja e tregut K3 2010

### 4.3. Të ardhurat e telefonisë mobile

Të ardhurat totale të katër operatorëve Mobil gjatë tremujorit të III-të të vitit 2010 janë 49.5 mil euro, që përbën një rritje prej rreth 20% në krahasim me tremujorin paraprak të këtij vitit, kur të ardhurat ishin 41 milion euro.

Në figurën e mëposhtme paraqitet tendenca e të ardhurave të telefonisë mobile në periudhën 2007-2010, ku mund të vërehet se fundi i vitit 2008 ishte viti i parë që shënoi rënie të të ardhurave të këtij segmenti të tregut.




Figura 13: Te hyrat nga telefonia mobile





Figura 14: Ndarja e tregut te telefonisë mobile ne baze të të hyrave

#### 4.4. Struktura e përdoruesve të telefonisë mobile

Struktura e përdoruesve të telefonisë mobile në raportet ndërmjet përdoruesve me parapagim (prepaid) dhe atyre me kontratë (postpaid) edhe në tremujorin e III të vitit 2010 vazhdon të jetë e qëndrueshme. Numri i përdoruesve me kontratë në raport me numrin total të përdoruesve është shumë i ulët. Rreth 4% e numrit të përgjithshëm e përbejnë përdoruesit me kontratë, ndërsa 96% e përbejnë përdoruesit me parapagim.

Figura 15 paraqet të dhënat mbi numrin e përdoruesve të telefonisë mobile, të ndarë në përdorues prepaid dhe postpaid për tremujorin e tretë të vitit 2010.



*Figura 15: Struktura e përdoruesve mobil K4 2007 - K3 2010*

#### 4.5. Trafiku telefonik

Në Figurën 16 është pasqyruar trafiku i detajuar telefonik hyrës, i gjeneruar nga dy operatorët e rrjeteve (MNO) dhe atyre të shërbimeve telefonike mobile (MVNO), sipas destinacionit të thirrjeve:

- ✓ brenda rrjetit,
- ✓ drejt rrjeteve të tjera mobile,
- ✓ rrjeteve fikse dhe
- ✓ ndërkombëtarë.



Në tremujorin e III-të 2010 nga rrjetet mobile janë origjinuar 441.5 mil. minuta, e cila përbën një rritje me 32.7% në krahasim me tremujorin e II-të, respektivisht 21% në krahasim me tremujorin e III-të të vitit 2009.

Vërehet se trafiku brenda rrjetit ka vazhduar me të njëjtin ritëm edhe në këtë tremujor, ku thirrjet brenda rrjetit përbëjnë 92% të thirrjeve të origjinuara nga përdoruesit e telefonisë mobile.

Kjo vlerë e trafikut brenda rrjetit rezulton të ketë ardhur si rezultat i ofertave dhe programeve të shumta tarifore që ofrojnë thirrje brenda grupeve me tarifa shumë të ulëta, kurse thirrjet drejt numrave gjeografike dhe thirrjet ndërkombëtare përbëjnë një pjesë shumë të vogël të thirrjeve dalëse.





Figura 16: Trafiku dalës mobil sipas destinacioneve 2007-III/2010

Në Figurën 17 është pasqyruar trafiku i detajuar telefonik hyrës në rrjetet e katër operatorëve mobil sipas origjinës së thirrjeve:

- ✓ nga rrjete të tjera celulare,
- ✓ rrjete fikse dhe
- ✓ ndërkombëtare (nuk janë përfshirë thirrjet brenda rrjetit).

Në tremujorin e tretë 2010 në rrjetet celulare janë terminuar 107.5 milion minuta, e cila përbën një rritje për 11% në krahasim me tremujorin e II-të 2010.

Nga të dhënat e paraqitura në grafik vërehet se trafiku hyrës ndërkombëtar zotëron pjesën më të madhe të thirrjeve të terminuara në mbi 70%, mirëpo, nga fundi i tremujorit të parë vërehet një tendencë në rënie e këtyre thirrjeve, kurse thirrjet nga rrjetet tjera mobile janë rritur 55% në krahasim me tremujorin e dytë 2010 (Figura 18).




*Figura 18: Trafiku hyrës sipas origjinës -2010*

## 5. Interneti

### 5.1. Numri i përdoruesve me qasje broadband në Internet dhe struktura e tyre

Në tremujorin e III të vitit 2010 janë rreth 4 sipërmarrës që kanë njoftuar ART për ofrimin e shërbimit të qasjes në Internet. Gjatë tremujorit të III të vitit 2010, ofrimi i shërbimeve të Internetit në brez të gjerë vazhdoi me rritjen e numrit të përdoruesve dhe rritjen e numrit të ofertave.


Në figurën 19 është paraqitur numri i përgjithshëm i përdoruesve të internetit.



*Figura 19: Numri i përgjithshëm i përdoruesve te internetit*


Sipas të dhënave zyrtare më të fundit të raportuara nga operatorët, numri i familjeve që kanë qasje në Internet me brez të gjerë është rreth 31.5 mijë apo afërsisht 30%. Bazuar në këto të dhëna, numri i linjave broadband/penetrimit të internetit në K3-2010 (të dhënat e fundit të azhurnuara) rezultojnë me një nivel prej 5.08%.

Në këto të dhëna nuk janë përfshirë të dhënat nga operatorët lokal (vlerësohet diku /rreth/mbi 150 ISP lokale të pa-licencuar), ku po qe se marrim si mesatare që çdo ISP e pa-licencuar ka përafërsisht 150 përdorues (vlerësim i ART ) shtrirja e internetit vlerësohet të jetë/ arrij min. 6.31%



*Figura 20: penetrimi i shërbimeve te internetit 2007-III/2010*

Ndarja e tregut për ofruesit e shërbimit të Internetit, ndërmjet PTK dhe ofruesve të tjerë të këtij shërbimi, (bazuar në të dhënat e PTK, IPKO Telecommunications, Kujtesa.net si dhe të operatorëve tjerë alternativ të këtij shërbimi), rezulton që IPKO zotëron 45.4%, PTK zotëron rreth 34%, kurse Kujtesa.net zotëron 19.6% pjesë të tregut bazuar në qasjen e ofruar në këtë shërbim për përdoruesit fundor (Figura 21).




*Figura 21: Ndarja e tregut të shërbimeve të internetit*

Numri i përdoruesve (lidhjeve) të internetit nëpërmjet modemit kabllor është teknologjia më dominuese me rreth 65 000 përdorues.

Qasja në internet përmes teknologjisë ADSL deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2010 është rreth 35.5 000 përdorues, nga të cilët rreth 94% janë përdorues individual, kurse pjesa tjetër prej 6% janë përdorues të biznesit.

Të dhënat e tremujorit të tretë të këtij viti për shërbimet e Internetit tregojnë për një rritje të përdoruesve të internetit nëpërmjet ADSL -it, e cila krahasuar me fundin e vitin 2009 është rritur rreth 11%.



*Figura 22: Linjat BB sipas teknologjisë*

Në tabelën nr. 7 janë paraqitur të dhënat sipas raportimeve të shtatë (7) ofruesve të licencuar për shërbimeve të interneti (nga 14 të licencuara), për numrin e abonentëve me akses broadband në Internet.

*Tabela 7: Numri i përdoruesve me qasje broadband në Internet (2007-III/2010)*

	2007	2008	2009	K1 2010	K2 2010	K3 2010
PTK	9625	20990	31552	32745	34068	35498
IPKO	71713	101,733	87,197	50298	50298	47685
Kujtesa	16000	16,000	17,712	18983	18691	20638
Artmotion			250	147	157	150
Vip Trading				109	264	228
ITS				523	627	582
Ati-Kos				235	260	280
<b>Totali I perdoruesve te sherbimeve broadband</b>	<b>97,338</b>	<b>138,723</b>	<b>136,711</b>	<b>103,040</b>	<b>104,365</b>	<b>105,061</b>

Nga të dhënat e raportuara vërehet se një numër i konsiderueshëm i lidhjeve broadband u ofrohet përdoruesve nga operatorët përmes kombinim kabllos koaksiale apo linjë bakri.

Teknologjia kryesore vazhdon të jetë Modemi kabllor me rreth 62%, ndërkaq rreth 35% të përdoruesve të internetit ky shërbim iu ofrohet përmes teknologjisë ADSL.


Si ofrues kryesor të internetit përmes kabllit koaksal janë IPKO dhe Kujtesa ndersa operator i vetëm i cili e ofron qasjen në internet për përdoruesit fundor përmes teknologjisë ADSL është PTK – TK. Nëse krahasojmë të dhënat e përdoruesve në fund të vitit 2007

dhe tremujorin e III të këtij viti vërehet një rritje signifikante e përdoruesve të këtij shërbimi përmes ADSL-it.

**Tabela 8:** Numri i përdoruesve me akses broadband në Internet (2007-III/2010)

Broadband sipas teknologjis	2007	2008	2009	K1 2010	K2 2010	K3 2010
xDSL	9625	20990	31552	32745	34068	35498
Modem kabllor	87713	117733	105,159	65495	65223	64917
Lidhje wireless (FWA) 2.4-5.5GHZ	N/a	N/a	N/a	4249	4272	3826
FTTH/B	N/a	N/a	N/a	46	47	45
Lidhje satelitore	N/a	N/a	N/a	0	0	0
Wireless Hot-spot (Wi-Fi)	N/a	N/a	N/a	235	260	260
Të tjera				270	495	495
Totali	97338	138723	136711	103040	104365	105041

Gjatë tremujorit të III 2010, janë vërejtur edhe disa ndryshime cilësore në ofrimin e qasjes broadband në Internet (figura 23).



**Figura 23:** Struktura e përdoruesve të internetit në bazë të kapacitetit

## ANEKSI 1

Regjistri i Licencave/Autorizimeve									
Nr	Emri i Operatorit/Kompanisë	Lista e Licencave							Totali (I licencave të dhëna për kompani)
		Licencë për Shërbime të Telefonisë Fikse	Licencë për Shërbime Telekomunikuese Mobile	Licencë për Shërbime MVNO (Mobile Virtual Network Operator)	Licencë për Shërbime të Internetit	Licencë për Pajisjet e Telekomunikimit Ndërkombëtar	Licencë për Shërbime Telekomunikuese Ndërkombëtare	Licencë për Shërbime me Vlerë të Shtuar	
1	Posta dhe Telekom i Kosovës SH.A	X	X		Autorizim			3	
2	IPKONet LLC	X	X		Autorizim	X	X	5	
3	Kujtesa LLC				Autorizim			1	
4	Dardafon.net- "Z Mobile" sh.p.k			X				1	
5	Dukagjini Telecommunications - "D3 Mobile" sh.p.k			X				1	
6	KONET sh.p.k	X				X	X	3	
7	Ipswiss sh.p.k				X	X	X	4	
8	VIP Trading & Albi				X	X	X	4	
9	Artmotion				X	X		2	
10	Aurora Israphone sh.p.k					X	X	2	
11	Albamex					X	X	2	
12	MCM net sh.p.k				X			1	
13	TVN Cablenet sh.p.k				X			1	
14	Broadband Kosova sh.p.k				X			1	
15	ATI-KOS				X			1	
16	ITS				X			1	
17	Telecom International Group				X			1	
18	ITT Dino				X			1	
19	Groting sh.p.k						X	1	
20	Initial Services sh.p.k						X	1	
21	Grand Media						X	1	
22	Fast Europe Ventures sh.p.k						X	1	

23	Call Center Kosova sh.p.k							X	1
24	Kristal Services sh.p.k							X	1
25	Zero Pozitive sh.p.k							X	1
26	Media Media Plus sh.p.k							X	1
27	Media Projekt <sup>1</sup>							X	1
28	Automatika sh.p.k							X	1
29	Leeloo sh.p.k							X	1
30	Operatorico sh.p.k.							X	1
30	<b>Totali</b> (I licencave te dhëna nga ART)	3	2	2	13	5	5	17	47

<sup>1</sup> Licenca e Ndërmarrjes “Media Projekt” ka skaduar me date 13.10.2010